

A Vini në UMass Memorial? Ja Se Si Ne Ju Mbajmë të Sigurt.

Ndërsa ne po bëjmë punë të mrekullueshme për t'u kujdesur për pacientët me COVID-19, gjithashtu kemi vendosur masa të rrepta sigurie për pacientët që nuk kanë COVID-19.

Mos vononi kujdesin! Nëse keni dhimbje, pësoni një vrarje ose mendoni se diçka nuk është në rregull me shëndetin tuaj, telefononi mjekun tuaj ose shkoni në Departamentin e Urgjencës ose kujdesin urgjent lokal. Të mos kontrolloheni mund të shkaktojë një rritje të simptomave ose përkeqësim të mëtejshëm të shëndetit tuaj.

Ne kemi aplikuar procedura për të garantuar mbrojtjen e pacientëve dhe kujdesdhënësve tanë. Zonat spitalore dhe ambulatorie janë vende të sigurta.

Varuni te ne për t'ju mbajtur të mbrojtur.

- Do të vini re hyrje të kufizuara që na lejojnë të kontrollojmë vizitorët që hyjnë.
- Solucion sanitizimi i duarve është lehtësisht i disponueshëm në të gjitha ndërtesat tona.
- Cdo njeri në spital vesh një maskë.
- Paraqitja/rregullimet e dhomave tona të pritjes dhe procesi i regjistrimit kanë ndryshuar për të mbajtur një distancë të sigurt midis pacientëve dhe stafit tonë.
- Ne po ndryshojmë modelet e trafikut, lëvizjeve të pacientëve dhe po përdorim sinjale të ngjashme me ato që do të shikonit në dyqanet ushqimore.
- Ashensorët mund të përdoren nga të gjithë pacientët duke ndjekur udhëzimet e distancës sociale (maksimum katër persona për ashensor).
- Për të inkurajuar proceset pa prekje, autorizimet/marrëveshjet e pacientit mund të kryhen verbalisht; para-regjistrimi është një opsion në disa raste; dhe kompensimet/pagesat mund të paguhet përmes telefonit kur është e përshtatshme. Kërkoni receta për rimbushje, caktoni takimet dhe paguani online duke përdorur [myChart](#), faqen tonë të internetit për pacientët.
- Pacientët pozitiv për COVID nuk sillen për vizitë në person, përveç kur është absolutisht e nevojshme.
- A keni ndonjë procedure apo operacion? Ju do të testoheni për COVID-19 përpara takimit tuaj.
- Protokollet tona të pastrimit janë intensifikuar gjatë pandemisë për të siguruar që zonat e përbashkëta dhe sipërfaqet me prekje të lartë të pastrohen më shpesh.

Gjëndjet shëndetësore nuk ndalen për një pandemi. Urgjencat e paparashikuara dhe sëmundjet kronike mund të keqësohen nga ankthi dhe frika, dhe shmangia e kujdesit rutinë mund të jetë e rrezikshme. Ne e kuptojmë se mund të hezitoni - se mund të keni shqetësim për trajtim në klinikë - por kur pritja mund të nënkuptojë shumë më keq, kini besim se jeni i sigurt me UMass Memorial. Kërkoni sot për takime virtuale ose në person.

NE JEMI KËTU PËR T'U KUJDESUR PËR JU!

Telefononi 855-UMASS-MD (855-862-7763).

Telefononi zyrën e doktorit tuaj.

Vizitoni faqen tonë [Make an Appointment](#) (Caktoni Takim).

Vizitat virtuale janë në dispozicion për shumicën e klinikave / zyrave ambulatorie UMass Memorial. Ju dhe mjeku juaj do të përcaktoni llojin më të mirë të takimit për ju.